



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE PRISHTINË

AUDIT MJEKËSOR

Analizimi i Plotësimit të Dokumentacionit Shëndetësor



Prill 2016

Komiteti për sigurimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore – QKMF / Prishtinë

Falenderojë drejtorin e DSHMS në Komunën e Prishtinës Dr.Arben Vitia për propozimin e realizimit të këtij auditi me qellim të ngritjes së cilësisë së kujdesit shëndetësor!

Falenderojë Drejtoreshën e QKMF-së në Prishtinë Dr.Merita Shkodra Brovina që kontriboi me entuziazëm në motivim, dhënjen e rekomandimeve, sygjërimeve, mbledhjen e të dhënave, për realizimin e auditit!

Falenderojë posaqërisht Dr.Florije Hyseni- Komiteti I Cilësisë për dhënjen e kontributit në realizimin e auditit, përmes sigurimit të materialit të nevojshëm, grumbullimit të të dhënave, dhënjen e sygjërimeve, rekomandimeve në analizimin e të dhënave.

Falenderojë Shefin e Njesisë Organizative Laborator Dr.Agron Kamberi për ndihmen në qasjen dhe grumbullimin e të dhënave dhe Inf. Përgjegjëse Kimete Idrizi!

Falenderojë Kryeinfermieren në QKMF-Prishtinë Myrvete Sopi për kontributin në realizimin e auditit.

Falenderojë Inf. Nexhmie Beshiri –Komiteti I Cilësisë në QKMF-Prishtinë për kontributin në mbledhjen e të dhënave!

Falenderojë posaqërisht Inf. Shqipe Gashi në Njesisë specialiste Konsultative QKMF Prishtinë për kontributin në mbledhjen e të dhënave!

Hyrje:

Ofrimi i kujdesit shëndetësor cilësor dhe të sigurt, është detyrim etik universal i profesionit mjekësor. Qëllimi kryesor i Institucionit është kujdesi për pacientin, ofrimi i kujdesit më të përshtatshëm i cili mbështet dhe korespondon me nevojat dhe kërkesat e pacientit. Pacientët janë të garantuar se të dhënat e tyre shëndetësore janë të kompletuara dhe te ruajtura ashtu si duhet. Dokumentet mjekësore të standardizuara dhe përmbajtja e tyre ndihmon të promovoj kontinuitet të kujdesit në institucione të ndryshme që ofrojnë shërbime shëndetësore për pacientin.

Në mbështetje të nenit 16 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për shëndetësi 2004/04 me qëllim të krijimit të bazës ligjore për unifikimin dhe standartizimin e dokumenteve shëndetësore në Institucionet Shëndetësore, është nxjerrë Udhëzimi Administrativ Nr.02/2010 Dokumentet Shëndetësore.

Ky Udhëzim Administrativ përcakton formën e dokumenteve, mënyrën dhe personat përgjegjës për plotësimin dhe administrimin e tyre në të gjitha Institucionet Shëndetësore.

Kjo është përpjekja e Ministrisë Shëndetësië për evitimin e përdorimit të dokumenteve shëndetësore të larmishme në Institucionet shëndetësore të të njejtit nivel duke u përpjekur që për lloje të njejtë të Institucioneve shëndetësore të kemi një standart, metodologji të njetë të mbledhjes , grumbullimit të të dhënave, me terminologji të njetë dhe mënyrë të njetë të plotësimit të tyre.

Punëtorët shëndetësor që plotësojnë dokumentet shëndetësore janë: Doktor i Mjekësisë, Specialisti i Mjekësisë Familjare, Mjeku Konsulent, Infermieri, Laboratoranti.

Dokumentet Shëndetësore të unifikuara dhe standartizuara sipas thirrjes dhe shifrimit janë:

Udhëzimi për Konsultim-DM0101,

Raporti nga Konsulta-DM0102

Udhëzim për Hulumtime Diagnostike-DM0103

Raporti kthyes nga Diagnostika-DM0104

Raporti kthyes nga Laboratori/gjak, urinë, feces-DM0105

Raporti kthyes nga laborator/hormone-Dm0106

Udhëresë për dhënjen e TerapiseParenterale-DM0108

Vërtetim për Nxënës dhe Student-DM0109

Regjistri i Pacienteve-DB02

Regjistri i kartotekës-DB03

Regjistri i Përdoruesve të Narkotikëve dhe Subëstancave psikotrope-DB04

Dokumentet Shëndetësore 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8 dhe 1.9 përbehen nga:

Pjesa e përgjithëshme ku perfshinë të dhënat nga për Institucionin, mjekun dhe pacientin.

Pjesa e veqant ku përshkruhet diagnoza, terapia, procedurat mjekesore, nëshkrimi dhe faksimili i punëtorit shëndetësor.

Dokumentet Shëndetësore 1.10, 1.11 përbëhen vetëm nga pjesa e përgjithëshme.

Dokumentet shëndetësore përdoren në Institucionet Shëndetësore të KPSH në QKMF, QMF, AMF dhe njësite e tyre organizative.

Dokumentet Shëndetësore 1.1, 1.3, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, dhe 1.11 përdoren në Departamentin e Mjekësisë Familjare.

Dokumentet Shëndetësore 1.2, 1.4, 1.5 dhe 1.6 përdoren në shërbimet Specialistike-konsultative, diagnostike dhe laboratorike, KPSH, KDSH, KTSh.

Pjesa e përgjithëshme e dokumenteve shëndetësore të përcaktuar nga neni 4 plotësohen nga puntoret shëndetësor të përcaktuar sipas nenit 3 të këtij udhezimi administrativ.

Pjesa e veqantë e dokumeenteve shëndetësore 1.1, 1.3, 1.9, 1.10 plotësohen nga Doktor i Mjekësisë ose Specialisti i Mjekësisë Familjare në departamentin e Mjekësisë Familjare në KPSH: QKMF, QMF, dhe AMF.

Dokumentet shëndetësore 1.2, 1.4, 1.5, dhe 1.6 plotësohen nga Mjeku konsulent në shërbimin përkatës specialistik, konsultativ dhe diagnostik.

Mbikeqyrja e Institucioneve Shëndetësore në lëmin e dokumenteve shëndetësore bëhet në baze të dispozitave ligjore në fuqi.

Mos përdorimi i dokumenteve shëndetësore të cilat përfshinë ky Udhëzim Administrativ në Institucionet Shëndetësore të KPSH, KDSH, dhe KTSh, parashihen masa ndëshkuese në vlerë prej 2.000.0 E

Për plotësimin jo korrekt të dokumenteve shëndetësore parashihen masa ndëshkuese për punëtorin shëndetësor emri i të cilit figuron në dokumentin gjegjës në lartesi prej 200.0 E.

UDHËZIM PËR KONSULTIM-DM0101

Cilët janë faktorët që ndikojnë në shkallën e referimit të mjekëve familjar?

- Shkathësitë e mjekut për detektim, interpretim, risigurim dhe trajtim.
- Kapacitetet ballafaqese të mjekut familjar, të pacientit dhe të familjes.
- Kualiteti i shërbimeve që janë në dispozicion në spitale.
- Bindjet e pacientit dhe pritjet se simptomat e caktuara janë çështje e spitalit.
- Karakteristikat demografike dhe sociale të popullatës së qendrës.

Disa nga faktorët e sipërpërmendur mund ndikojnë njëkohësisht. Kapaciteti ballafaques i mjekut familjar ndryshon varësisht nga pacienti, sistemet, sindroma apo simptomat dhe mund të dobësohet nganjëherë për shkak të ndonjë përvoje jo të mirë.

Kualiteti i shërbimeve të ofruara gjithashtu mund të ndryshoj kohë pas kohe.

Çka duhet t'i komunikojnë mjekët familjar mjekëve të shërbimit specialistik konsultativ

Arsyen e referimit

Detajet e anamnezës familjare, sociale dhe e sëmundjeve të kaluara, të pacientit.

Detajet e episodave aktuale së bashku me specifikat e ndonjë faktori të mundshëm social dhe psikologjik të cilët mund të ndihmojnë diagnozën dhe menaxhimin.

Çka duhet mjekët e shërbimit specialistik konsultativ t'i komunikojnë mjekëve familjar.

Përmbledhjen koncize të diagnozës, menaxhimit dhe prognozës, e cila duhet t'i komunikohet mjekut familjar sa më parë. Shpesh herë ndodhë që pacientët duke qenë të rrethuar me një ambient të panjohur spitalor, nuk janë në gjendje t'i kuptojnë shpjegimet e mjekëve spitalor, andaj mbështeten në mjekët e tyre familjar që t'iu shpjegojnë rezultatet e vizitës spitalore dhe, mu këtu qëndron rëndësia e komunikimit të shpejtë në mes të mjekut konsultativ dhe atij familjar.

Në çdo komunikim në mes të mjekut familjar dhe atij konsultativ, çështjet në vijim shërbejnë si asistent i memories për gjërat esenciale.

Mjeku familjar:

Njohuritë e mjekut familjar për prapavijën e pacientit: personaliteti, raportet, puna, shprehitë dhe kapaciteti i komplaincës.

Arsyet për referim. Kjo duhet të reflektojë të dyja, pasiguritë dhe realitetin e motiveve të përziera për referim.

Pjesët relevante të anamnezës mjekësore, përfshirë këtu edhe trajtimet e tanishme eventuale.

Deklarata e qartë e problemeve, përfshirë shenjat dhe hulumtimet dhe rëndësinë për pacientin, familjen dhe të tjerët dhe për mjekun familjar.

Pikëpamja e pacientit për natyrën e problemit, shkakun e saj dhe progresin.

Kopjet e letrës referuese duhet të ruhen në dosjen e pacientit.

Mjeku Konsultant

Problemi ashtu siç prezentohet, kohëzgjatja, faktorët etiologjik, shenjat fizike, hulumtimet. Sinjifikanca e problemit në aspektin e natyrës së sëmundjes dhe konsekuencave për pacientin.

Ndonjë problem tjetër i identifikuar

Opsionet e trajtimit në kontekst të përgjithshëm

Plani i menaxhimit i pajtuar me pacientin, këshillat e dhëna, trajtimi i rekomanduar, përcjellja (nëse aplikohet) e aranzhuar.

Çka i është thënë pacientit dhe/apo familjes së tij për natyrën, shkakun dhe progresin e sëmundjes.

Udhëzimi për Konsultim DM0101 plotësohet nga profesionistët shëndetësor në :

Departamentin e Mjekesisë Familjare në rast referimi për konsultim në Shërbimin specialistik konsultativ në KPSH (nëse egziston shërbimi i tillë), në KDSH (Spitali Rajonal, Shërbimet e Shëndetit mandore, etj) në rajonin përkatës ose KTSh (QKUK) për regjionin e Prishtinës.

Kujdesi Emergjent në KPSH në rast referimi për Spitalin Rajonal ose KTSh (te rastet emërgjente).

- Institucioni Shëndetësor

Në këtë fushë shënohet thirrja dhe vendi i institucionit shëndetësor, psh, QKMF Prishtinë.

Kodi

Fusha kodi është e dedikuar për numër unik i cili identifikon institucionin shëndetësor në fjalë. Kjo rubrikë nuk plotësohet- mbetet e zbrazët, deri në perpilimin dhe miratimin e numrit identifikues të institucioneve dhe njërive të tyre organizative.

- Fusha publik/privat

Kjo fushë plotësohet ashtu që zgjedhet katrori përkatës, varësisht cili sektorë i takon institucioni në fjalë.

- Vendi

Shënohet vendi ku ushtron veprimtarine institucioni shëndetësor gjegjë.

- Numri i Karteles Shëndetësore

Në fushën përkatëse shënohet numri i Kartelës Shëndetësore të Pacientit. Secili banorë i Kosovës duhet të ketë Kartelën Shëndetësore e cila hapet gjatë vizitës së parë të pacientit në këtë nivel të kujdesit shëndetësor. Deri me tani nuk janë mbuluar nevojat e popullatës së Kosovës me këtë dokument bazë, por aty ku është në përdorim Kartela Shëndetësore, profesionistët shëndetësor janë të obliguar të shënojnë numrin e Kartelës në DM0101.

- Numri i regjistrimit

Shënohet numri i regjistrimit të pacientëve sipas numrit rendor të regjistruar gjatë vizitës.

- Mjeku

Shënohet emri dhe mbiemri i mjekut i cili realizon vizitën dhe plotëson këtë dokument.

- Kodi i Mjekut

Ky është numër unik identifikues i profesionistëve shëndetësor në Sistemin Shëndetësor të Kosovës. Numri gjenerohet nga SMRH në momentin e licencimit të profesionisteve shëndetësor nësektorin për licencim të MSh. Kjo rubrike mbetet e zbrazët, deri në nje vendim në të ardhmën.

- Numri i telefonit të mjekut

Shënohet numri i telefonit të mjekut

- E-mail

Shënohet adresa elektronike e mjekut.

- **Alergjitë**

Në këtë fushë shënohet gjendjet alergjike të dokumentuara ose të njohura të pacientit.

- **Kompania e Sigurimeve Shëndetësore**

Shënohet emri i kompanisë së sigurimit, ku pacienti është i siguruar. Kjo fushë për momentin mbetet e zbrazët për arsye së Kosova akoma nuk ka Fond të Sigurimit Shëndetësor privat apo publik.

- **Kodi**

Shënohet numri identifikues i kompanisë së sigurimit shëndetësor. Kjo fushë mbetet e zbrazët për momentin.

- **Numri personal**

Shënohet numri nga leternjoftimi aktual deri në vendimin definitiv të institucioneve përkatëse.

- **Emri i pacientit**

Shënohet emri i pacientit.

- **Emri i prindit**

Shënohet emri i prindit (nënës ose babait) të pacientit. Nëse pacienti nuk ka prind shënohet emri i kujdestarit të pacientit.

- **Mbiemri i pacientit**

Shënohet mbiemri i pacientit.

- **Viti i lindjes**

Shënohet ditëlindja e pacientit sipas radhës së dhënë në dokument.

- **Gjinia**

Zgjedhet fusha përkatëse të ciles i takon pacienti.

- **Adresa**

Shënohet adresa e plotë e vendbanimit të pacientit

- **Statusi bashkëshortor**

Zgjedhet fusha përkatëse të cilës i takon pacienti.

- **Profesioni,**

Shënohet profesioni i pacientit.

- **Institucioni shëndetësor ku udhëzohet pacienti**

Shënohet emri i Institucionit shëndetësor dhe vendi ku udhëzohet pacienti.

- **Konsulenti**

Shënohet emri dhe mbiemri i mjekut konsulent, te i cili udhëzohet pacienti. Me këtë fushë jemi të vetëdijshëm për problemet në të cilat do të hasim deri në implementimin e plotë të konceptit të Mjekesisë Familjare.

- **Qëllimi i udhëzimit**

Në këtë fushë mjeku shënon në pika të shkurtëra qëllimin e udhëzimit të pacientit te konsulenti.

- **Anamneza**

Shënohet shkurt dhe preciz anamneza e pacientit.

- **Ekzaminimet**

Në këtë fushë shënohen të gjitha ekzaminimet (procedurat) të cilat janë kryer me pacientin para se të percaktohet nevoja për udhëzim për konsultim. Në Kosovë është në përdorim ICD, prandaj në pjesën për Kode shënohen kodet përkatëse për secilin ekzaminim të realizuar në pacientin.

- **Trajtimi i tanishëm**

Në këtë fushë shënohen barnat të cilat është duke i përdorur pacienti, ndërsa në pjesën Kodi i barnave, shënohen kodet përkatëse të barnave.

- **Diagnoza e punës**

Në këtë fushë shënohet diagnoza e punës me shkrim, ndërsa në pjesën kodë shënohet kodë përgjegjës i sëmundjes sipas ISD10, i cili është klasifikim zyrtar i sëmundjeve në Kosovë.

- **Data**

Shënohet dita , muaji dhe viti i udhëzimit

-**Nënshkrimi dhe faksimili i mjekut-**

Në këtë fushë mjeku i cili plotëson udhëzimin, nënshkruan dhe vendose faksimiline tij.

UDHËZIM PËR HULUMTIME DIAGNOSTIKE- DM0103

“Arritja te diagnoza është arritje kruciale, e cila hap rrugën drejt prognozës dhe trajtimit” (Royal College of General Practitioners).

Udhëzimi për Hulmtime Diagnostike-DM0103 plotësohet nga mjeku në: Departamentin e Mjekesisë Familjare në KPSH (QKMF, QMF, AMF), në të gjitha rastet kur për të arritur diagnostifikimin adekuat, nevojiten informacione shtesë (imazherike, laboratorike, etj) përmes shfrytëzimit të hulumtimeve diagnostike, mbrenda institucionit shëndetësor nivelit të njejtë të kujdesit shëndetësor (nëse egziston shërbim i tillë), në nivelin dytësor shëndetësor (Spitali Rajonal), Shërbimet e Shëndetit Mendor, etj në rajonin përkatës ose në KTSh (regjioni i Prishtinës).

Ky dokument duhet të plotësohet sipas fushave përkatëse.

- **Institucioni Shëndetësor**

Në këtë fushe shenohet thirrja dhe vendi i institucionit shendetesore, psh, QKMF Prishtinë.

- **Kodi**

Fusha kodë është e dedikuar për numër unik i cili identifikon institucionin shëndetësor në fjalë. Kjo rubrikë nuk plotësohet- mbetet e zbrazët, deri në përpilimin dhe miratimin e numrit identifikues të institucioneve dhe njërive të tyre organizative.

- **Fusha publik/privat**

Kjo fushë plotësohet ashtu që zgjedhet katrori përkatës, varësisht cili sektorë i takon institucioni në fjalë.

- **Vendi**

Shënohet vendi ku ushtron veprimtarinë institucioni shëndetësor gjegjës.

- **Numri i Kartelës Shëndetësore**

Në fushën përkatëse shënohet numri i Kartelës Shëndetësore të Pacientit. Secili banorë i Kosoves duhet të ketë Kartelën Shëndetësore e cila hapet gjatë vizitës së parë të pacientit në këtë nivel të kujdesit shëndetësor. Deri me tani nuk janë mbuluar nevojat e popullatës së Kosovës me këtë dokument bazë, por aty ku është në përdorim Kartela Shëndetësore, profesionistët shëndetësor janë të obliguar të shënojnë numrin e Kartelës në DM0103.

- **Numri i regjistrimit**

Shënohet numri i regjistrimit të pacientëve sipas numrit rendorë të regjistruar gjatë vizitës.

- **Mjeku**

Shënohet emri dhe mbiemri i mjekut i cili realizon vizitën dhe plotëson këtë dokument.

Kodi i Mjekut

Ky është numër unik identifikues i profesionistëve shëndetësor në Sistemin Shëndetësor të Kosovës. Numri gjenerohet nga SMRH në momentin e licencimit të profesionistëve shëndetësor nësektorin për licencim të MSh. Kjo rubrike mbetet e zbrazët, deri në një vendim në të ardhmën.

- Numri i telefonit të mjekut

Shënohet numri i telefonit të mjekut

- E-mail

Shënohet adresa elektronike e mjekut.

- Alergjite

Në këtë fushë shënohet gjendjet alergjike të dokumentuara ose të njohura të pacientit.

- Kompania e Sigurimeve Shendetesore

Shënohet emri i kompanisë së sigurimit, ku pacienti është i siguruar. Kjo fushë për momentin mbetet e zbrazët për arsye së Kosova akoma nuk ka Fond të Sigurimit Shëndetësor privat apo publik.

- Kodi

Shënohet numri identifikues i kompanisë së sigurimit shëndetësor. Kjo fushë mbetet e zbrazët për momentin.

- Numri personal

Shënohet numri nga leternjoftimi aktual deri në vendimin definitiv të institucioneve përkatëse.

- Emri i pacientit

Shënohet emri i pacientit.

- Emri i prindit

Shënohet emri i prindit (nënës ose babait) të pacientit. Nëse pacienti nuk ka prind shënohet emri i kujdestarit të pacientit.

- Mbiemri i pacientit

Shënohet mbiemri i pacientit.

- Viti i lindjes

Shënohet ditëlindja e pacientit sipas radhës së dhënë në dokument.

- Gjinia

Zgjedhet fusha përkatëse të ciles i takon pacienti.

- Adresa

Shënohet adresa e plotë e vendbanimit të pacientit

- Statusi bashkëshortor

Zgjedhet fusha përkatëse të cilës i takon pacienti.

- Profesionit,

Shënohet profesioni i pacientit.

- Profesionit, shënohet profesioni i pacientit.

- Institucioni shëndetësor ku udhëzohet pacienti

Shënohet emri i Institucionit shëndetësor dhe vendi ku udhëzohet pacienti.

- Njësia Organizative

Shënohet emri i njësisë organizative të institucionit ku është udhëzuar pacienti për hulumtime diagnostike, psh shërbimi i Laboratorit, Shërbimi i Radiologjisë, etj.

- Kodi

Në këtë rubrike shënohet numri unik i cili identifikon njësinë organizative në fjalë. Kjo rubrikë mbetet e zbrazët, deri në përpilimin dhe miratimin e numrit unik identifikues të institucioneve dhe njësive të tyre organizative.

- **Fusha Publi/privat-**

Zgjedhet fusha përkatëse

- **Adresa e Institucioni**

Shënohet adresa e institucionit ku realizohet hulumtimi diagnostik.

- **Vendi**

Shënohet vendi ku ndodhet institucioni ku është udhëzuar pacienti për hulumtime diagnostike.

- **Mjeku Konsulent**

Shënohet emri dhe mbiemri i mjekut – konsulent te i cili udhëzohet pacienti për hulumtime diagnostike.

- **Diagnoza e punës**

Në këtë fushë shënohet diagnoza e punës së mjekut me shkrim, ndërsa në pjesën Kodi shënohet kodi gjegjësisht i sëmundjes ICD10.

- **Procedura**

Shënohet procedura diagnostike dhe kodi përkatës sipas ICD.

- **Data**

Shënohet dita, muaji dhe viti i udhëzimit.

- **Vendi**

Në këtë fushë shënohet vendi i Institucioni Shëndetësor

- **Nënshkrimi dhe faksimili i Mjekut**

Në këtë fushë mjeku i cili plotëson udhëzimin, nënshkruan dhe vendos faksimilin e tij.

Qëllimi

Unifikimi dhe standartizimi i dokumenteve shëndetësore në Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor, në shërbimet specialistike-konsultative dhe diagnostike të Kujdesit Parësor, Kujdesit Dytësor dhe Tretësor Shëndetësor.

Kjo është përpjekja e Ministrisë Shëndetësië për evitimin e përdorimit të dokumenteve shëndetësore të larmishme në Institucionet shëndetësore të të njejtit nivel duke u përpjekur që për lloje të njejtë të Institucioneve shëndetësore të kemi një standart, metodologji të njetë të mbledhjes, grumbullimit të të dhënave, me terminologji të njejtë dhe mënyrë të njejtë të plotësimit të tyre.

Kriteri

Simbas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2010 qdo Dokument Shëndetësor duhet të plotësohet në të gjitha rubrikat e domosdoshme për t'u plotësuar. Disa rubrika që u ceken me lart nuk plotësohet- mbetet e zbrazët, deri në përpilimin dhe miratimin nga MSh. Shkrimi duhet të jetë i lexueshëm

Çdo pacient i ekzaminuar i trajtuar ose i referuar, në institucionin shëndetësor duhet të ketë të plotësuar dokumentacionin Shëndetësor.

Standardi

Dokumentacioni Shëndetësor duhet të plotësohet në tërësi në të gjitha rubrikat e domosdoshme për t'u plotësuar. 100% e rubrikave të domosdoshme synojmë të jenë të plotësuara, kurse

rubrikat te cilat nuk plotësohet- mbeten të zbrazët, deri në perpilimin dhe miratimin në të ardhmën nga MSh.

Materiali dhe metodologjia e punës

Për grumbullim e të dhënave të cilësisë së plotësimit të dokumenteve shëndetësore në Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor në Komunën e Prishtinës, ndihmoi ekipa e punës e përbërë prej profesionistëve shëndetësor në QKMF Prishtinë : Dr Merita Shkodra-Brovina – Drejtoreshë në QKMF Prishtinë, Dr.Vjollca Zeqiri Koorditore e kontrollit të Cilësisë në QKMF Prishtinë, Dr Florie Hyseni- Morina – Komiteti I Cilësisë në QKMF Prishtinë, Dr. Agron Kamberi- Shef në Njësine Organizative Laborator në QKMF Prishtinë, Inf. Përgjegjëse Kimete Idrizi në Njësine Organizative Laborator në QKMF Prishtinë, Kryeinfermiere Myrvete Sopi në QKMF Prishtinë, Inf. Shqipe Gashi në Njësine Specialistike Konsultative në QKMF Prishtinë, Inf Nexhmie Ajvazi në QKMF Prishtinë.

Analizimi dhe prezantimi i të dhënave është bërë nga Dr.Vjollca Zeqiri-Koordinator e Cilësisë, ndërsa prezantimi i rezultateve është bërë me metoda statistikore adekuate dhe jane paraqitur si rezultate në nivel të përgjithshëm të të gjitha QMF-ve të përfshira në auditim. Në rezultate u komentua perqindja e permbushjes se ketij standarti të rubrikave të domosdoshme për t'u plotësuar në Dokumentet Shëndetësore, dhe atyre të nevojshme për tu plotësuar (deri në implementimin e plotë të konceptit të Mjekësisë Familjare) dhe është krahasuar plotësimi i qdo rubrike në mes të dy dokumenteve shëndetësore. Metoda eshte retrospektive.

Për dokumentin Udhëzimi për Hulmtime Diagnostike-DM0103 për QMF u zgjodhen 120 mostëra reprezentuese në mënyrë randomiane kurse për dokumentin Udhëzimi për Konsultim-DM0101 u zgjodhen 60 mostra, gjithashtu në mënyrë randomiane.

Shkurtesat

KPSH – Kujdesi Parësor Shëndetësor
QMF – Qendra e Mjekësisë Familjare
QKMF - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
MSh - Ministria e Shëndetësisë

Rezultatet:


Gjithsej janë analizuar 120 referime të mbrendshme për hulumtime diagnostike të zgjedhura në menyre randomiane dhe rezultatet e tyre janë paraqitur në tabelat dhe diagramet gjegjëse.

Në tabelen nr.1 dhe diagramin nr.3 është paraqitur numri dhe përqindja e plotësimit të fushes përkatëse, thirrja dhe vendi i institucionit shëndetësor në dokumentin shëndetësor udhëzim për Hulmtime Diagnostike-DM0103 nga punëtorët shëndetësor në QKMF-QMF-AMF-të e Komunës së Prishtinës.

Tabela Nr.1


Institucioni Shëndetësor		
Të plotësuar	90	75%
Të pa plotësuar	30	25%

Diagrami Nr.1



Nga tabela 1 dhe diagrami 1 i mësipërm shohim se 75% e punëtorëve shëndetësor në Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë plotësuar fushën e Institucionit Shëndetësore, kurse 25% e tyre nuk e kanë plotësuar fare.

Diagrami Nr.1.1 është paraqitur krahasimi i fushës Institucioni Shëndetësor të dy dokumenteve shendetesore Udhëzim për Hulmtime Diagnostike-DM0103 dhe Udhëzim per Konsultim.




Në tabelen nr.2 dhe diagramin nr.2 janë paraqitur rezultatet e plotësimit të fushës Publik/Privat në dokumentin shëndetësor udhëzim për Hulmtime Diagnostike-DM0103 nga puntorët shëndetësor në QKMF-QMF-AMF- të e Komunës së Prishtinës.

Tabela Nr.2


Publik/Privat		
Të plotësuar	58	48%
Të pa plotësuar	62	52%

Diagrami Nr. 2



Nga tabela 2 dhe diagrami 2 i mësipërm shohim se 48% e punëtorëve shëndetësor në Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë plotësuar fushën ePublik/Privat, kurse 52% e tyre nuk e kanë plotësuar.

Diagrami Nr.2.1 është paraqitur krahasimi i fushës Publik/Privat




Në tabelen nr.3 dhe diagramin nr.3 është paraqitur numri dhe përqindja e plotësimit të fushës perkatese, vendi, në dokumentin shëndetësor udhëzim për Hulmtime Diagnostike-DM0103 nga punëtorët shëndetësor në QKMF-QMF-AMF-të e Komunës së Prishtinës.

Tabela Nr.3


Vendi		
Të plotësuar	70	58%
Të pa plotësuar	50	42%

Diagrami Nr.3



Nga tabela 3 dhe diagrami 3 i mësipërm shohim se 58% e punëtorëve shëndetësor në Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë plotësuar fushën Vendi, kurse 42% e tyre nuk e kanë plotësuar.

Diagrami Nr.3.1 është paraqitur krahasimi i fushës Vendi të dy dokumenteve shëndetësore Udhëzim për Hulmtime Diagnostike-DM0103 dhe Udhëzim për Konsultim.




Në tabelen nr.4 dhe diagramin nr.4 është paraqitur numri dhe përqindja e plotësimit të fushës perkatese, Numri i Regjistrimit, në dokumentin shëndetësor udhëzimit për Hulmtime Diagnostike-DM0103 nga punëtorët shëndetësor në QKMF-QMF-AMF-të e Komunës së Prishtinës.

Tabela Nr.4


Numri I Regjistrimit		
Të plotësuar	78	65%
Të pa plotësuar	42	35%

Diagrami Nr.4



Nga tabela 4 dhe diagrami 4 i mësipërm shohim se 65% e punëtorëve shëndetësor në Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë plotësuar fushën numri i regjistrimit, kurse 35% e tyre nuk e kanë plotësuar.

Diagrami Nr.4.1 është paraqitur krahasimi i Numri i regjistrimit.




Në tabelen nr.5 dhe diagramin nr.5 është paraqitur numri dhe përqindja e plotësimit të fushës perkatese, Mjeku, në dokumentin shëndetësor udhëzim për Hulmtime Diagnostike-DM0103 nga punëtorët shëndetësor në QKMF-QMF-AMF-të e Komunës së Prishtinës.

Tabela Nr.5


Mjeku		
Të plotësuar	54	45%
Të pa plotësuar	66	55%

Diagrami Nr.5



Nga tabela 5 dhe diagrami 5 i mësipërm shohim se 45% e punëtorëve shëndetësor në Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë plotësuar fushën perkatese, kurse 55% e tyre nuk e kanë plotësuar.

Diagrami Nr.5.1 është paraqitur krahasimi i fushës Mjeku të dy dokumenteve shendetesore Udhëzim për Hulmtime Diagnostike-DM0103 dhe Udhëzim per Konsultim.




Në tabelen nr.6 dhe diagramin nr.6 është paraqitur numri dhe përqindja e plotësimit të fushës përkatëse, Kodi i Mjekut, në dokumentin shëndetësor udhëzim për Hulmtime Diagnostike-DM0103 nga punëtorët shëndetësor në QKMF-QMF-AMF-të e Komunës së Prishtinës.

Tabela Nr.6


Kodi I Mjekut		
Të plotësuar	54	45%
Të plotësuar pa	66	55%

Diagrami Nr.6



Nga tabela 6 dhe diagrami 6 i mësipërm shohim se 45% e punëtorëve shëndetësor në Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë plotësuar fushën përkatëse, kurse 55% e tyre nuk e kanë plotësuar.

Diagrami Nr.5.1 është paraqitur krahasimi i fushës Mjeku.




Në tabelen nr.7 dhe diagramin nr.7 është paraqitur numri dhe përqindja e plotësimit të fushës përkatëse, Alergjitë, në dokumentin shëndetësor udhëzim për Hulmtime Diagnostike-DM0103 nga punëtorët shëndetësor në QKMF-QMF-AMF-të e Komunës së Prishtinës.

Tabela Nr.7


Alergjite		
Të plotësuar	45	38%
Të pa plotësuar	75	62%

Diagrami Nr.8



Nga tabela 7 dhe diagrami 7 i mësipërm shohim se 38% e punëtorëve shëndetësor në Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë plotësuar fushën përkatëse, kurse 62% e tyre nuk e kanë plotësuar.

Në diagramin nr.7.1 është paraqitur Krahasimi I fushës së Alergjisë




Në tabelen nr.8 dhe diagramin nr.8 është paraqitur numri dhe përqindja e plotësimit të fushës përkatëse, Emri, Mbiemri, Emri I Prindit, Viti I lindjes, Gjinia, Adresa, në dokumentin shëndetësor udhëzim për Hulmtime Diagnostike-DM0103 nga punëtorët shëndetësor në QKMF-QMF-AMF-të e Komunës së Prishtinës.

Tabela Nr.8


Emri, Mbiemri, Emri I Prindit, Viti I lindjes, Gjinia, Adresa!		
Të plotësuar	120	100%
Të pa plotësuar	0	0%

Diagrami Nr.8



Nga tabela 8 dhe diagrami 8 i mësipërm shohim se 100% e punëtorëve shëndetësor në Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë plotësuar fushat përkatëse.

Në diagramin nr.8.1 është paraqitur krahasimi i fushës, Emri, mbiemri, emri i prindit, viti i lindjes, gjinia.




Në tabelen nr.9 dhe diagramin nr.9 është paraqitur numri dhe përqindja e plotësimit të fushës përkatëse, Profesionit, në dokumentin shëndetësor udhëzim për Hulmtime Diagnostike-DM0103 nga punëtorët shëndetësor në QKMF-QMF-AMF-të e Komunës së Prishtinës.

Nr.9


Profesioni		
Të plotësuar	30	25%
Të pa plotësuar	90	75%

Diagrami Nr.9



Nga tabela 9 dhe diagrami 9 i mësipërm shohim se 25% e punëtorëve shëndetësor në Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë plotësuar fushën përkatëse, kurse 75% e tyre nuk e kanë plotësuar.

Në diagramin nr.9.1 është paraqitur Krahasimi I fushës Profesionit.




